REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-47048
Më 6.5.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 6.5.2014, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për hartimin e projekteve për ndërtimin e disa rrugëve lokale, dhe mori këtë

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 28.4.2014, për lejimin e hartimit të projekteve për ndërtimin e disa rrugëve lokale, në Komunën e Prizrenit, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për hartimin e:

a. Projektit për ndërtimin e rrugëve lokale në fshatin Malësi e Vërrinit,
b. Projektit për ndërtimin e rrugëve lokale në fshatin Nashec,
c. Projektit për ndërtimin e rrugëve lokale në fshatin Kushtrim, dhe
d. Projektit për ndërtimin e rrugës "Hajdar Shala" në Prizren.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbime Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbime Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-49194
Më 6.5.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Estoni dhe pagesës së mëditjeve për Ramadan Tafallarin, zyrtar komunal, kryetari i Komunës, më 6 maj 2014, miratoi këtë:

# VENDIM

## Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Ramadan Tafallarit, zyrtar komunal, për në Estoni, me qëllim të pjesëmarrjes në vizitën studimore, që organizohet UN –HABITAT-i, e që ka për qëllim njohjen e praktikave dhe përvojave të suksesshme në fushën e mjedisit, me fokus të veçantë në menaxhimin e mbeturinave dhe të ujit.

Vizita studimore do të realizohet nga data 12 maj deri me 16 maj 2014, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurin.

## Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

## Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

## Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

## Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-49196
Më 6.5.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Japoni dhe pagesës së mëditjeve për Nezir Rexhepin, zyrtar komunal, kryetari i Komunës, më 6 maj 2014, miratoi këtë:

# V E N D I M

## Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Nezir Rexhepit, zyrtar komunal, për në Japoni, me qëllim të pjesëmarrjes në vizitën studimore, që organizohet JICA, e që ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve në menaxhimin e mbeturinave drejt një shoqërie të shëndosh. Vizita studimore do të realizohet nga data 11 maj deri me 25 maj 2014, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurin.

## Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

## Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

## Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, i lartcekuri, si dhe arkivi.

## Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-47048
Më 6.5.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 6.5.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e hartimit të Planit Rregullues Urban për një pjesë të lagjes "Bajram Curri", dhe mori këtë

# KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, i datës 2.5.2014, për lejimin e hartimit të Planit Rregullues Urban për një pjesë të lagjes "Bajram Curri".

I propozohet Komitetit për Politikë dhe Financa që ta shqyrtojë këtë propozim dhe, pas shqyrtimit, atë t'ia propozojë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Obligohet Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor që, pas marrjes së këtij konkluzioni, të procedojë me lëndën në Komitetin për Politikë dhe Financa e pastaj në Kuvendin e Komunës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdeset: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, KPF-ja si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-47048
Më 6.5.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 6.5.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e hartimit të Planit Rregullues Urban për një pjesë të lagjes "Bajram Curri", dhe mori këtë

## K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, i datës 2.5.2014, për lejimin e hartimit të Planit Rregullues Urban për një pjesë të lagjes "Bajram Curri".

I propozohet Komitetit për Politikë dhe Financa që ta shqyrtojë këtë propozim dhe, pas shqyrtimit, atë t'ia propozojë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Obligohet Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor që, pas marrjes së këtij konkluzioni, të procedojë me lëndën në Komitetin për Politikë dhe Financa e pastaj në Kuvendin e Komunës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdeset: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, KPF-ja si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-49202
Më 6.5.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Shëndetësisë për lejimin të mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të 24 pacientëve, kryetari i Komunës më 6 maj 2014, miratoi këtë:

# V E N D I M

## Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, i datës 29.4.2014, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për mjekim të pacientëve: 1. Hamdi Karavidaj, 2. Nakshije Çollaku, 3. Fatmir Menekshe, 4. Xhyzide Berisha, 5. Hyrmet Shuki, 6. Sabija Muja, 7. Kumrije Gashi, 8. Xhon Merdita, 9. Mahmut Asani, 10. Senada Quni, 11. Resmije Alija, 12. Enver Posdeli, 13. Nashide Beksaç, 14. Xhemile Kryeziu,15. Hamëz Hoti, 16. Nehari Mati, 17. Shengyl Lakush, 18. Shpresa Ninaj, 19. Sulltan Shala, 20. Besim Kabashi, 21. Luan Kryeziu, 22. Vjollca Skenderi, 23. Melahat Braha dhe 24. Jemin Gutaj

Për këtë qëllim, lejohen mjetet në lartësi prej 300 € për secilin prej të lartpërmendurve.

## Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve i Drejtorisë së Shëndetësisë.

## Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

## Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe arkivi.

## Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-64048
Më 6.5.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur, më 6.5.2014, me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për lejimin e zhvillimit të procedurave për themelimin e Këshillit për fshatin Zym të Hasit i paraparë me Ligjin nr. 04/L-196, dhe mori këtë

## KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 24.4.2014 për lejimin e zhvillimit të procedurave ligjore për themelimin e Këshillit për fshatin Zym të Hasit, i paraparë me nenin 4 të Ligjit për Fshatin Zym i Hasit nr. 04/L-196.

I propozohet Komitetit për Politikë dhe Financa që ta shqyrtojë këtë propozim dhe, pas shqyrtimit, atë t'ia propozojë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, që, pas marrjes së këtij konkluzioni, të procedojë me lëndën në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdeset: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, KPF-ja, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-49207
Më 6.5.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për manifestimin kulturor "Zgjimi me Art 2014", kryetari i Komunës, më 6 maj 2014, miratoi këtë:

# VENDIM

## Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 21.4.2014, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për manifestimin kulturor tradicional të komunitetit turk "Zgjimi me Art 2014", i cili manifestim do të mbahet gjatë muajit qershor 2014, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën prej 2500 €.

## Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

## Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

## Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe arkivi.

## Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-49216
Më 6.5.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare për Klubin e karatesë "Komandant Drini", kryetari i Komunës, më 6 maj 2014, miratoi këtë:

# VENDIM

## Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 29.4.2014, bazuar në kërkesën e Klubit të karatesë "Komandant Drini" nga Prizreni, për përkrahje financiare, me qëllim të organizimit të turneut të tretë tradicional të karatesë që mbahet me 1.6.2014 në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohen mjetet në shumën prej 500 €.

## Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

## Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

## Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe arkivi.

## Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-47048
Më 6.5.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 6.5.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Inspektorateve, për lejimin e shpalljes së tenderit për rrënimin e ndërtimeve pa leje në territorin e Komunës së Prizrenit, dhe mori këtë

## KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Inspektorateve, i datës 28.4.2014, për lejimin e rrënimit (ekzekutimit) të ndërtimeve pa leje dhe punimeve të tjera pa leje në territorin e Komunës së Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Inspektorateve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Inspektorateve, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-47048
Më 6.5.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 6.5.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e infrastrukturës rrugore, ujësjellësit, kanalizimit dhe instalimit elektrik në Zonën e Parkut të Biznesit-faza e tretë, dhe mori këtë:

# K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, i datës 18.4.2014, për lejimin e ndërtimit të infrastrukturës rrugore, ujësjellësit, kanalizimit dhe instalimit elektrik, në Zonën e Parkut të Biznesit-faza e tretë, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-49218
Më 6.5.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë për lejimin e mjeteve për mbulimin e shpenzimeve të transportit (sjelljes) të automjetit për fikje e zjarrit, nga Anglia në Prizren, kryetari i Komunës, më 6 maj 2014, miratoi këtë:

# VENDIM

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, i datës 2.5.2014, për lejimin e mjeteve financiare lidhur me mbulimin e shpenzimeve të transportit (sjelljes) të automjetit për fikje e zjarrit, nga Anglia në Prizren, kështu që për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të transportit (për karburante dhe shpenzime tjera përcjellëse) lejohen mjetet në shumën prej 4000 €.

II. Ky automjet për fikje e zjarrit është donacion për Komunën e Prizrenit nga ana e Rotary Club nga Anglia nëpërmjet Rotary Club Prizreni.

III. Mjetet e lartcekura, si në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet në xhirollogarinë e Rotary Club nga Anglia (Rotary District 1290).

IV. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë.

V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

VI. Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave si dhe arkivi.

VII. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/01149221
Më 6.5.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit Zyrës për Çështje Gjinore për lejimin e mjeteve për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve -1 Qershori, kryetari i Komunës, më 6 maj 2014, miratoi këtë:

# VENDIM

## Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Çështje Gjinore, i datës 2.5.2014, për lejimin e mjeteve financiare për organizimin dhe shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve -1 Qershori, kështu që për realizimin e këtij manifestimi lejohen mjetet në shumën 1500 €.

Për nderë të këtij manifestimi është përgatitur dhe do të realizohet nga NjDNj e Komunës së Prizrenit projekti "Dita ime";

## Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Administratës.

## Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Administratës, Zyra për Çështje Gjinore dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

## Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Administratës, Zyra për Çështje Gjinore dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

## Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-47048
Më 6.5.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 6.5.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik për lejimin e shpalljes së tenderit për trajnimin e guidave (ciceronëve), dhe mori këtë:

## K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, i datës 5.5.2014, për lejimin e trajnimit profesional të guidave (ciceronëve) për nevojat e Komunës së Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

EC MANDRYSHE

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-53119
Më 20.5.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 20.5.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, për lejimin e shpalljes së tenderit për ndërtimin e varrezave të reja në Landovicë, dhe mori këtë

KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, i datës 13.5.2014, për lejimin e ndërtimit të varrezave të reja në Landovicë (nivelizimi, rrafshimi dhe kufizimi i sipërfaqes së hapësirës ku duhet të ndërtohen varrezat), kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-53119
Më 20.5.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 20.5.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me disa kompjuter dhe printer, dhe mori këtë

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, i datës 7.4.2014, për lejimin e furnizimit me 10 kompjuter dhe 10 printer për nevojat e Komunës, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-55205
Më 20.5.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Administratës, për lejimin e pjesëmarrjes së Valdete Shpendit, zyrtare komunale, në trajnimin që organizohet nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, si dhe për lejimin e mjeteve për pagesë të trajnimit që do të mbahet në Prishtinë dhe në Maqedoni, kryetari i Komunës, më 20 maj 2014, miratoi këtë:

# V E N D I M

## Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës, dhe lejohet pjesëmarrja e Valdete Shpendit, zyrtare komunale, në trajnimin që organizohet nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës që mbahet në Prishtinë nga data 27 maj deri me 31 maj 2014, si dhe lejohen e mjetet për pagesë të këtij trajnimi në shumën 250 €.

## Neni 2

Lejohet udhëtimit zyrtar i Valdete Shpendi, zyrtare komunale, me qëllim të pjesëmarrjes në trajnimin që organizohet nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (vazhdim i trajnimit të mbajtur në Prishtinë), që do të mbahet me datën 29, 30 dhe 31 maj 2014 në Maqedoni, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurën.

## Neni 3

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Administratës.

## Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

## Neni 5

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, e lartcekura, si dhe arkivi.

## Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-53119
Më 20.5.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 20.5.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik për lejimin e shpalljes së tenderit për rehabilitimin e fasadave të objekteve të vjetra që gjenden në Qendrën Historike të Prizrenit, dhe mori këtë:

# KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, i datës 13.5.2014, për lejimin e rehabilitimit të fasadave të objekteve të vjetra (shtëpive) që gjenden në Qendrën Historike të Prizrenit, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-53119
Më 20.5.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 20.5.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik për lejimin e shpalljes së tenderit për hartimin e projektit "Ndriçimi i objekteve monumentale" në Prizren, dhe mori këtë:

## K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, i datës 13.5.2014, për lejimin e hartimit të projektit "Ndriçimi i objekteve monumentale" në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-55209
Më 20.5.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b dhe g të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryetari i Komunës, më 20 maj 2014, mori këtë:

# AKTVENDIM

I. Formohet dhe emërohet Komisioni teknik për zbatimin e programit (projektit) të hartuar nga ana e Komisionit të Kuvendit të Komunës i formuar për organizimin dhe shënimin e manifestimeve të Qershorit: 10 Qershorit - Ditës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe 12 Qershorit - Ditës së Çlirimit të Prizrenit.

II. Për anëtarë të këtij Komisioni emërohen:

1. Urim Ukimeri,
2. Lulëzim Ibri,
3. Nexhat Çoçaj,
4. Zeqir Xhaferi,
5. Bashkim Lubovci,
6. Ramadan Tafallari.

III. Detyrat e Komisionit teknik do të jenë: Të zbatoj programin e hartuar nga ana e Komisionit të Kuvendit të Komunës, i formuar për organizimin e manifestimeve të Qershorit.

IV. Për këtë qëllim lejohen mjetet e nevojshme financiare për mbulimin e shpenzimeve të krijuara gjatë shënimit të festave të Qershorit dhe se mjetet e lejuara do të paguhen pas parashtrimit të faturave përkatëse për këto shpenzime.

V. Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin IV të këtij Aktvendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe mallrave dhe shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

VI. Komisioni nga pika II e këtij Aktvendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me ligjin në fuqi.

VII. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të emëruarit.

VIII. Udhëzim juridik: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së tij, Komisionit për Ankesa, në KK Prizren.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-55219
Më 20.5.2014

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, për mbështetje financiare për shënimin e 31 Majit–Ditës Ndërkombëtare kundër pirjes së duhanit, kryetari i Komunës, më 20 maj 2014, miratoi këtë:

# V E N D I M
# PËR LEJIMIN E MJETEVE

## Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 13.5.2014 për mbështetje financiare për shënimin e 31 Majit – Ditës Ndërkombëtare Kundër Pirjes së Duhanit, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjete në lartësi prej 1500 €.

Ky projekt do të implementohet nga Këshilli Rinor, në bashkëpunim me organizata të tjera rinore, Këshill i nxënësve, Qendrën e Rinisë, PMSh-në etj., dhe do të monitorohet nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ky projekt del nga komponenta 4 të Politikave Rinore.

## Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

## Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

## Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe arkivi.

## Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-55222
Më 20.5.2014

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, kryetari i Komunës me 20 maj 2014, mori këtë

# AKTVENDIM

I. Formohet dhe emërohet komisionit për verifikimin dhe identifikimin e rasteve të familjeve skamnore të cilat kanë bërë kërkesë për furnizim me material ndërtimor.

II. Për anëtarë të këtij komisioni emërohen:
   a. Reshat Mehmeti, nga DPMS – kryesues,
   b. Zana Belloda, nga DUPH,
   c. Xhylije Elshani, nga DES, anëtarë.

III. Detyrat e komisionit do të jenë: të bëj verifikimin dhe identifikimin e të gjitha rasteve të familjeve skamnore të Komunës së Prizrenit, të cilat kanë bërë kërkesë për furnizim me material ndërtimor dhe pas verifikimit, identifikimit dhe vlerësimit, t'ia propozoj listën përfundimtare Komisionit i cili bën përzgjedhjen e përfituesve të meremetimit të shtëpive të familjeve skamnore të Komunës së Prizrenit.

IV. Komisioni nga pika II e këtij Aktvendimi, detyrat dhe përgjegjësitë e tij do t'i ushtrojë në pajtim me ligjin në fuqi.

V. Për zbatimin e këtij Aktvendimi do të kujdesen: Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe të emëruarit.

VI. Ky Aktvendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

VII. Udhëzim juridik: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së tij, Komisionit për Ankesa, në KK Prizren.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-53119
Më 20.5.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 20.5.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për lejimin e shpalljes së tenderit për furnizim me një aparat fotokopjues për nevojat e QPS-së, dhe mori këtë

# KONKLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, i datës 15.4.2014, për lejimin e furnizimit me një aparat fotokopjues për nevojat e QPS-së, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-53119
Më 20.5.2014

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 20.5.2014 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, për lejimin e shpalljes së tenderit për realizimin e projektit: "Planifikimi i ushtrimeve dhe vlerësimi i gatishmërisë së zjarrfikësve, dhe mori këtë

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, i datës 16.5.2014, për lejimin e realizimit të projektit: "Planifikimi i ushtrimeve dhe vlerësimi i gatishmërisë së zjarrfikësve", që do të realizohet në muajin qershor, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen: Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë, Drejtoria e Ekonomisë dhe e Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja